



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 25 Datë 18/10/ 2013

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILL MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995, "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore ne Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 642, date 11.10.2005, "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore,

URDHËROJ :

1. Lirimimin nga detyra të anëtareve të Këshillit Mbikëqyrës në Sh.A "Qendra Sportive", Tirane:
  - Z. Bashkim MALE
  - Z. Vasil BICAJ
  - Zj.Miranda BASHI
2. Emërimin si anetare në Këshillin Mbikëqyrës të Sh.A "Qendra Sportive", Tirane:
  - Z. Aziz TAHIRI
  - Z. Ermir Hazizaj
  - Zj.Evisi KOPLIKU
3. Në zbatim të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36, të bëhen ndryshimet përkatëse në Regjistër.

Ky Urdhër hyj në fuqi menjëherë.

*Be protokollet*

MINISTRI





REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TREGTISË  
DHE SIPËRMARRJES  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

URDHËR

Nr. 86 Datë 6/1/2014

PËR

NDRYSHIM NË KËSHILLIN MBIKQYRËS

Mbështetur në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, dhe Vendimin Nr. 642, datë 11.10.2005 "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore;

URDHËROJ:

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës në sh.a "Qendra Sportive" Tiranë:
  - Zj. Evisi KOPLIKU
2. Emërimin si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të sh.a "Qendra Sportive" Tiranë :
  - Zj. Rudina KARAMUÇA, Përfaqësuese e MZHETS..
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR

Aplikenti;

Kelidon Tashani



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA E TIRANES  
QENDRA SPORTIVE SH.A  
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E SHOQERISE

VENDIM

NR. 27007

DATE 08.09.2016

i Asamblese se Pergjithshme të Shoqerise  
"QENDRA SPORTIVE" sh.a.

**QENDRA SPORTIVE SH.A.** është një Shoqëri Aksionere Shqiptare e regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar, me nr. NIPT J61813020F, më datë 01.03.1996, me një kapital prej 635.276.000,00 Lekë e ndarë në 635.276,00 aksione me vlerë prej 1.000,00 Lekë secila ("Shoqëria"), me Aksionerë Bashkia Tiranë, mbi bazë të VKM nr. 86, datë 03.02.2016 për "Transferimin e të drejtave të pronësisë të shoqërisë "Qendra Sportive" SH.A Tiranë me kapital 100 përqind shtetëror, nga Ministria e Zhvillimit, Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë".

Sipas shkronjës "P" të nenit 64 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, për "Vetqeverisjen vendore" Kryeyatri i Bashkisë në cilësinë autoritetit që ka të drejtën për të emëruar anëtarët e organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të Bashkisë dhe ka të drejtën e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të këshillit mbikqyrës.

Janë të pranishëm në mbledhje:

Kryetari i Bashkisë Tiranë, në cilësinë e përfaqësuesit të aksionerit.

Mbledhja e Asamblesë se Zakonshme thirret dhe organizohet në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (i ndryshuar)

RENDI I DITES:

Emërimin e Kryetarit dhe të Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë.  
Të tjera.

DUKE QENE SE:

Aksionerët janë njoftuar në mënyrë të rregullt në lidhje me Rendin e Ditës, dhe janë mbledhur me vullnetin e tyre në këtë Mbledhje për të diskutuar dhe për të vendosur më pas

1

në lidhje me çështjet që ju janë adresuar atyre nëpërmjet këtij Vendimi të Asamblesë së Aksionerëve ("Vendimi");

Aksioneri është duke vendosur mbi çështjet e specifikuar në këtë Vendim, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo akt në fuqi të Shoqërisë. Kuorumi i kërkuar nga ligji dhe nga Statuti i Shoqërisë është arritur në mënyrë të vlefshme dhe Asambleja ka të drejtë të vendosë mbi pikat e Rendit të Ditës;

Aksioneri, përmes nënshkrimit të këtij Vendimi, shpreh miratimin për datën e Mbledhjes dhe mbi çështjet të cilat do të miratohen nga ky Vendim.

PERFUNDIMISHT, U VENDOS:

Lirimi nga detyra i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës në Qendrën Sportive SH.A:

Z. Aziz Tahiri  
Z. Ermir Hazizaj  
Znj. Rudina Karamuca

Të emërohet Kryetar i Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë:

Znj. Anuela Ristani.

Të emërohen anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë:

Z. Ermal Tahiri  
Z. Ditjon Baboçi

Ngarkohet zj. Kaliopi Tasellari, Juriste pranë Qendrës Sportive SH.A për regjistrimin e Vendimit të mësipërm pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit QKR.

Asnjë vendim tjetër nuk u mor në Asamblesë e Përgjithshme të Aksionerëve, e cila u mbyll në orën 10:00.

Tiranë, më \_\_\_\_\_

Aksionerët

Bashkia Tiranë  
Erion Veliaj

Kryetar



2